



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.760/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada-Gillogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i përfaqësuar nga Blerim Sallahu, paraqitur kundër vendimit me numër 860-2021 të dt.04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatit përfundimtar, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 06.03.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pa bazuar apeli Anr.760/2021 i datës 05.03.2021, i paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i cili kërkon që të urdhërohet KQZ-ja, ti verifikoi dhe ti numëroj 9.748 (nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) pako me flet votime të ardhura prej jashtë vendit të dorëzuara në Postën Nr. 6, në Rrugën “Agim Ramadani” në Prishtinë.

## A r s y e t i m

Me datën 05.03.2021, PZAP-i ka pranuar apelin Anr.760/2021, të paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, nr. 860-2021 të dt.04.03.2021, me të cilin janë shpallur rezultatet përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021, duke mos përfshirë 9748 (nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) vota të votuesve jashtë Kosove.

Parashtruesi i apelit pretendon se fletëvotimet e dërguara nga ana e votuesve jashtë Kosove duhet të pranohen, të klasifikohen dhe të numërohen për arsyen themelore objektive, sepse të gjithë dërguesit e këtyre pakove me fletëvotime i kanë dorëzuar dërgesat me kohë të duhur, brenda afatit të përcaktuar pa asnjë vonesë, dhe i konsiderojnë votuesit si të pa fajshëm për tu konsideruar si votë e rregullt. Në bazë të nenit 96.2 të LZP-së parashihet se “*Vota përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ-së*”. Mirëpo kjo normë ligjore nuk ka konkretizuar përmes Rregullës Zgjedhore, për situatat e jashtëzakonshme objektive si forca madhore (vis major).

Më tej në apel parashtruesi shton se ekzistojnë edhe arsye tjera objektive rrethanore që arsyetojnë pranimin dhe numërimin e këtyre votave, duke qenë se zgjedhje e 14.02.2021 kanë qenë të jashtëzakonshme dhe të parakohshme, dhe se të njëjtat janë edhe objektivisht të jashtëzakonshme për shkak të rrethanave të shkaktuara nga fuqia madhore në rastin konkret Pandemia Covid 19, e cila rrethanë nuk varet nga faktori njeri.

Në apel theksohet se për shkak të afateve shumë të shkurtër për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, KQZ-ja nuk ka arritur ti përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për periudhën e aplikimit për votim jashtë vendit të paraparë me Planin Operacional të miratuar nga KQZ, duke ia mohuar të gjithë aplikuesve për votim jashtë Kosove të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike.

Si provë për pretendimet e tyre parashtruesi i apelit ka bashkangjitur në apel: korrespondencat e mbajtura në mes të anëtarëve të KQZ-së nga radhët e subjektit politik LVV-së dhe postës-DHL, si dhe Planin Operacional të KQZ-së.

Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i që të urdhërojë KQZ-në, për verifikimin dhe numërimin e 9748 pakove me fletëvotime të dorëzuar në postë nga votuesit jashtë Kosove, të cilat kanë arritur në KQZ pas afatit të përcaktuar më datë 12 shkurt 2021.

Në përgjigje në apel të datës 05.03.2021, KQZ-ja, ka theksuar se në mbledhjen e datës 02.03.2021, Nr.23/2021, Kryeshefi Ekzekutiv ka njoftuar KQZ-në se Sekretariati ka pranuar pako të supozuara me fletëvotime pas përfundimit të periudhës së votimit përmes postës, e cila është përmblyllur më 12 shkurt 2021.

Tërheqja e tyre është bërë në tri ditë të ndryshme, më datën 18 dhe 19 shkurt 2021, janë tërhequr nga posta e shpejtë DHL 691 dhe 27 pako, ndërsa më 25 shkurt nga fahu postar janë tërhequr 9,030 pako. Këto pako janë vendosur në depon e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe të njëjtat janë trajtuar si material josensitiv, i cili do të shkatërrohet brenda afatit ligjor së bashku me materialet tjera.

Nga pikat postare te lartcekura nuk është raportuar ndonjë vones për arritjen e dërgesave postare në Kosovë, po ashtu nuk është raportuar për mbyllje të transportit ajror në mes të Kosovës dhe shteteve tjera, pra kjo nënkupton se trafiku ajror është zhvilluar normalisht.

Ndërsa sa i përket afateve ligjore për ankesa në PZAP, kjo nuk është kompetencë e KQZ-së, sepse këto afate janë të përcaktuara më Ligjin për Zgjedhjet, e sa i përket forcës madhore (vis major) të cekura në pretendimet e palës ankuese, KQZ-ja nuk ka qenë e njoftuar nga askush se ka pasur ndonjë pengesë madhore në arritjen e dërgesave postare në Kosovë, e po ashtu vlen të theksohet se totali i dërgesave postare është rreth 43 mijë dërgesa, të cilat kanë arritur brenda afatit ligjor të përcaktuar me Ligjin dhe rregullat e KQZ-së, dhe ashtu si kanë arritur këto dërgesa të cilat janë dërguar me kohë dhe për të cilat nuk ka pasur pengesa madhore do duhej të arrinin edhe dërgesat tjera sikur të ishin dërguar me kohë.

Andaj, KQZ propozon që ankesa të refuzohet si e pa pabazuar, ashtu siç e parasheh neni 96.2 i LZP si dhe neni 4.4 i Rregullës Zgjedhor nr.03/2012.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, gjeti se:

#### **Apeli është i pa bazuar**

Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara duke mos përfshirë 9748 (nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) vota të votuesve jashtë Kosove, ku barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk ka mundur te konstatoj se iu është mohuar e drejta për votim aplikuesve jashtë Kosove, për faktin se thëniet në apel nuk mbështetën në asnjë provë konkrete ashtu siç është pretenduar në apel.

Dispozitat ligjore të LZP-së, kanë përcaktuar procedurat në bazë të cilave çdo qytetar mund ta ushtroj të drejtën e vet kushtetuese për të u zgjedhur dhe për të zgjedhur, dhe çdo

anashkalim i zbatimit të këtyre dispozitave nënkupton cenim i procesit të rregullt zgjedhor, dhe me këtë cenim i të drejtave të qytetarëve, edhe atyre që kanë qenë në këtë proces zgjedhor si kandidat për tu zgjedhur, si dhe votuesve të cilët ju janë përmbajtur rregullave të dispozitave ligjore për t'i ushtruar të drejtat e tyre.

Andaj duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e këtij rasti, mënyra e tërheqjes së e tyre është bërë në tri ditë të ndryshme, më datën 18 dhe 19 shkurt 2021, dhe nga posta e shpejtë DHL janë tërhequr 691 dhe 27 pako, ndërsa më 25 shkurt nga fahu postar janë tërhequr 9,030 pako. Rrjedhimisht shihet qartë se të njëjtat janë pranuar pas përfundimit të periudhës së votimit për persona jashtë Kosove dhe pas ditës së zgjedhjeve 14.02.2021. Bazuar në nenin 96.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku shprehimisht thekson se : *votat përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohen nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve*, sikurse përcaktohet me rregullat e KQZ-së. Si dhe nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, ku shprehimisht thotë se: *Votat Jashtë Kosovës duhet të pranohen nga KQZ-ja 24 orë para ditës së zgjedhjeve*.

Andaj, bazuar gjithashtu, në Aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese, në Rastin Nr. KI207/19, e cila vendosi, si në vijim :

I. Konstatohet se aktgjykimet (A.A.U.Zh. Nr.20/2019 i datës 30 tetor 2019 dhe A.A.U.ZH.nr.21/2019 i datës 05 nëntor 2019 e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nuk janë në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Lidhje me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Paneli vlerësoi se sa i përket forcës madhore (vis major) të cekura në pretendimet e palës ankuese, nga përgjigja në ankesë del se e KQZ-ja nuk ka qenë e njoftuar nga askush se ka pasur ndonjë pengesë madhore në arritjen e dërgesave postare në Kosovë, e po ashtu vlen të theksohet se totali i dërgesave postare ka qenë rreth 43 mijë dërgesa, të cilat kanë arritur brenda afatit ligjor të përcaktuar me Ligjin dhe rregullat e KQZ-së, pa qene te penguara nga ndonjë force madhore dhe ashtu si kanë arritur këto dërgesa të cilat janë dërguar me kohë, ashtu do te duhej të arrinin edhe dërgesat tjera sikur të ishin dërguar me kohë.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lart e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafët 2 dhe 3, neni 119 paragrafi 5, neni 120 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.760/2021 më datë 06.03.2021

**Kryesuese e Panelit**

Kymete Kicaj



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi lejohet ankesa, brenda afatit 24 orë nga dita e pranimit, në Gjykatën Supreme.